



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:281596

Datë: 10.08.2022

Numri i dokumentit: 03315861

P.nr.1018 /21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjyquese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekincë-Sadiku, në lëndën penale kundër të pandehurit S. M. nga fshati B., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale, vjedhje e sherbimeve, nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77, të KPRK-se, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr...../2021, të datës 13.12.2021, pas mbajtjes së seancës fillestare dhe publike, më datën 12.07.2022, mori dhe shpalli, ndërsa me date. 10.08.2022, perpiloj këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri S. M., nga babai H., nëna Sh., e gjinisë N.u, i lindur me datë,në fsh.B., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme ,i pa punë, i martuar,baba i fëmive, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptarë, shtetase i Republikës së Kosovës, me numër personal të identitetit,të lëshuar nga Republika e Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 16.06.2021, në kohë të pavërtetuar,në fshatin B.,Komuna e Gjilanit, i pandehur në vazhdimësi në mënyrëm të paautorizuar,ka shfrytëzuar energji elektrike,në atë mënyrë që derisa i pandehuri për shkak të mos pagesës së borgjit është ç'kyçur nga rrjeti elektrik,e me rastin e kontrollimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it,kanë konstatuar se i pandehuri S. M.,si shfrytëzues i energjisë elektrike,me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme,ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike,ashtu që, ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik,dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e paautorizuar të energjisë elektrike,me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike,duke e dëmtuar,të dëmtuaren KEDS-distrikti në Gjilan,sipas pro faturave:DGLHP..... e dates 17.09.2021,në shumë të përgjithshme prej 63.20Euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin77 , të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 70, 71 dhe 72 të KPRK, neni 248 lidhur me nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit të lartcekurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i pandehuri S. M., dënohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-i për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej **20 € (njëzetë euro)** të gjitha këto në afat prej **15 ditëve** pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm..

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë Gjykatë me datën , 15.12.2021 ka dorëzuar aktakuzat, PP.II.nr...../2021 ,të dates 13.12.2021, ndaj të pandehurit S. M.nga fshati B.,Komuna e Gjilanit, për shkak se ka kryer veprën penale vjedhja e sherbimeve nga neni 314 par. 1,lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata me datë 12.07.2022, ka mbajtur seancën fillestare në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit K.F. dhe i pandehuri S. M..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores se shtetit i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre, duke shtuar se për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike nuk ka mundur ta paguajë borxhin e të dëmtuarës,i njejt ka deklaruar se me të dëmtuaren do të arrij një marveshje për pagesën e borgjit,sa më shpejt që është e mundur,andaj i ka propozuar gjykates që ti shqiptoj një dënim më të butë duke premtuar se nuk do të bie ndesh me ligjin në të ardhmen.

2.Gjendja faktike e vërtetuar Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i pandehuri i lartcekur, ka kryer veprën penale, vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par. 1lidhur me nenin 77 të KPRK-ës në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

3.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 të KPP-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur dhe të njëjtit, i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit.

4.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjykata po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike Gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 për realizmin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën KEDS e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarës gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditëve, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.1018/21
datë 10.08.2022

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Mevlide Shaban

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.